



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Drejtoria e Financës

Informacion

Mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave (faza e parë)

-Gjatë hartimit të buxhetit afatmesëm 2018-2020, në tabelën nr. 1 “Parashikimi i të ardhurave afatmesme” është parashikuar dhe zëri “Të ardhura të trashëguara nga viti i kaluar”. Ky zë nga ana e Bashkisë planifikohet çdo vit në buxhet. Arsyeja e planifikimit të këtij zëri qëndron në fakt se , të ardhurat që Bashkia realizon gjatë muajit dhjetor të çdo viti dhe që rakordohen me degën e thesarit nëpërmjet aktit të rakordimit, përdoren gjatë vitit pasardhës. Gjithashtu të ardhurat sipas aktit të anulimit , i cili hartohet në fillim të vitit pasardhës me degën e thesarit, për shpenzimet e kryera të një viti më pare, planifikohen në vitin pasardhës buxhetor.

-Gjatë hartimit të buxhetit vjetor të Bashkisë , fillimisht planifikohen të gjitha detyrimet e prapambetura dhe më pas planifikohen shpenzimet e çdo vitit buxhetor.

-Shpenzimet për investime (në programin menaxhimi rrugor) po i japim të detajuara si më poshtë:

Investimet në vitin 2017 janë 1,884,267 mijë lekë, nga të cilat:

- 1,727,166 mijë lekë janë investime nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve dhe
- 157,101 mijë lekë investime nga të ardhurat e Bashkisë.

Për vitin 2018 investimet janë planifikuar në vlerën 658,342 mijë lekë, nga të cilat:

- 500,000 mijë lekë janë investime nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve dhe
- 158,342 mijë lekë investime nga të ardhurat e Bashkisë.

Për vitin 2019 investimet janë planifikuar në vlerën 750,395 mijë lekë, nga të cilat:

- 500,000 mijë lekë janë investime nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve dhe
- 250,395 mijë lekë investime nga të ardhurat e Bashkisë.

Për vitin 2020 investimet janë planifikuar në vlerën 788,401 mijë lekë, nga të cilat:

- 500,000 mijë lekë janë investime nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve dhe
- 288,401 mijë lekë investime nga të ardhurat e Bashkisë.

000/lekë

Funksionet	Plan 2017	Plan 2018	Dif pl 2018-2017	Plan 2019	Dif pl 2019-2018	Plan 2020	Dif pl 2020-2019
Menaxhimi Rrugor+transporti Publik	157,101	158,342	1,241	250,395	92,053	288,401	38,006
Menaxhimi Rrugor FZHR	1,727,166	500,000	-1,227,166	500,000	0	500,000	0

Pra shpenzimet për investime nga të ardhurat e Bashkisë nga njëri vit në tjetrin vijnë duke u rritur, ndërsa investimet e planifikuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve janë me rënie pasi ne nuk parashikojmë dot për tre vitet në vazhdim se cilat projekte do të përfitojnë nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

NEPUNESI AUTORIZUES
KLETJON KITA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË**

Drejtoria e Financës

Nr. _____ Prot.

Korçë, ____ . ____ . ____

Lënda: Dorëzim i Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020, të rishikuar

Drejtuar: Drejtoria e Financave Vendore
Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit
Ministria e Financave
Tiranë

Në zbatim të Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” , Udhëzimit Plotësues të MF nr 10/2 datë 13.07.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor” po ju depozitojmë PBA 2018-2020, të rishikuar, të Bashkisë Korçë sipas tabelave të mëposhtme.

Bashkëngjitur:

- a. Tabelën nr. 1, “Parashikimi i të ardhurave afatmesme të NJQV”, i rishikuar.
- b. Tabelën nr. 2, “Parashikimi I shpërndarjes së burimeve financiare afatmesme të shpenzimeve për NJQV”, i rishikuar.
- c. Tabelën nr. 3, “Formatet e planifikimit të tavanëve afatmesme të rishikuara të shpenzimeve për NJQV”.
- d. Tabelën nr. 5, “Kërkesat shitesë të programit buxhetor afatmesëm”.
- e. Informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave (faza e parë).

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

Konceptoi:
Denada Tabaku
Drejtori:
Valbona Ziko

**NËPUNËS AUTORIZUES
KLETJON KITA**